



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

Viti mësimor 2015-2016

Faza e dytë

Klasa 12

OLIMPIADA KOMBËTARE E HISTORISË

Skema e vlerësimit të testit të historisë

1.

a)

- Papa si autoriteti më i lartë i kishës, kishte të drejtën të kurorëzonte perandorët, duke treguar epërsinë e pushtetit fetar. **1 pikë**
- Në favor të kishës paguhej taksë e veçantë si në para, ashtu edhe në natyrë e njohur si “e dhjeta e kishës”. **1 pikë**
- U krijua një shtresë e fuqishme e feudalëve kishtarë, të quajtur “princa të kishës”. **1 pikë**
- Kisha mori në zotërim prona të pafundme. **1 pikë**

b)

- Figura morale e kompromentuar e një pjese të klerikëve.
- Humbje e vlerave të hershme të krijimit të saj.
- Devijim i rolit të kishës në lidhje me nevojat shpirtërore dhe problemet e popullit.
- Krijimi i strukturës së Inkuizicionit të Shenjtë dhe qëndrimi persekutor i saj tronditi besimin e njerëzve të thjeshtë.
- Imazhi i kishës u cënua edhe nga të ashtuquajtura “letra falje” ose indulgenca.

2 pikë

Nxënësi fiton:

2 pikë nëse shkruan dy nga të mësipërmet

1 pikë nëse shkruan një nga të mësipërmet

c)

- Forcimi i monarkive kombëtare pikërisht në këtë periudhë. **1 pikë**
- Degëzimi i krishtëritimit në ortodoksizëm dhe katolicizëm në vitin 1054. **1 pikë**
- Dështimi i fushatave fetar-ushtarake (kryqëzatave) që u organizuan posaçërisht për rritjen e autoritetit të kishës, por që në fakt patën efektin e kundërt duke e minuar këtë autoritet. **1 pikë**
- Presioni që vinte nga Lindja ku përhapja e besimit islam, ngushtonte gjithnjë e më shumë hapësirat e krishterimit. **1 pikë**

2.

Në datën 7 maj 1945, në Rejms, aleatët (Francë, Angli dhe SHBA-ja) nënshkruan aktin e kapitullimit të Gjermanisë. **1 pikë**

Në datën 8 maj 1945, në Berlin, ky akt u nënshkrua edhe nga BS-ja, për shkak të mungesës në aktin e ditës 7 maj.

1 pikë

Nëse në dy datat e para ishin nënshkrimi i kapitullimit de jure, më 9 maj 1945, u dorëzua dhe garnizoni i fundit gjerman në Pragë.

1 pikë

3.

a) **4 pikë**

Perestrojka që synonte ristrukturimin e ekonomisë pra lejin e konkurrencës dhe iniciativës së lirë në prodhimin e të mirave materiale.

Glasnost që synonte dëgjimin e opinionit publik dhe një lloj liberalizimi në politikat qeveritare.

Nxënësi fiton:

4 pikë nëse evidenton dy reformat me synimet përkatëse;

3 pikë nëse evidenton dy reformat me synimin e njërës prej tyre;

2 pikë nëse evidenton vetëm dy reformat;

1 pikë nëse evidenton vetëm një nga reformat;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

b) **6 pikë**

Perestrojka

- shteti nuk subvenciononte ndërmarrjet që dilnin me humbje;
- ndërmarrjet ekonomike vet administroheshin dhe vetëfinancoheshin;
- drejtuesit e ndërmarrjeve vendosnin për sasinë e prodhimin, pagat e punëtorëve;
- lejimi i krijimit të shoqërive të përbashkëta në industri, transport etj.;
- lejimi i krijimit të ndërmarrjeve me kapital të huaj duke inkurajuar firmat perëndimore;
- reduktimi shpenzimeve ushtarake;
- reduktimi i rolit të partisë në ekonomi.

Nxënësi fiton:

3 pikë nëse shkruan tre nga të mësipërmet;

2 pikë nëse shkruan dy nga të mësipërmet;

1 pikë nëse shkruan një nga të mësipërmet;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Glasnost

- drejtimi të vazhdonte të ishte në duart e partisë por të reduktohej roli i saj;
- rritja e rolit të inteligjencës;
- kufizimi i censurës;
- lejimi i shprehjes së mendimit;
- lejimi i votimit të fshehtë ku votohej për më shumë se një kandidat;
- vendosja e formës presidenciale në qeverisje.

Nxënësi fiton:

3 pikë nëse shkruan tre nga të mësipërmet;

2 pikë nëse shkruan dy nga të mësipërmet;

1 pikë nëse shkruan një nga të mësipërmet;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

4.

a)

Konferenca e Pezës në 16 Shtator 1942;

1 pikë

Kongresi i Përmetit 24 - 28 Maj 1944;

1 pikë

Mbledhja II e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar në Berat 20 - 23 Tetor 1944.

1 pikë

b) **8 pikë**

Në Konferencën e Pezës, **u hodhën bazat e pushtetit** nëpërmjet vendimit për formimin e *këshillave nacionalçlirimtare* dhe të *Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar* si organ drejtues i këtyre këshillave.

2 pikë

Kongresi i Përmetit përbën hapin tjetër madhor në linjën e pushtetit nëpërmjet **zgjedhjes së organeve të pushtetit me karakter legjislativ dhe ekzekutiv**, ndonëse me karakter të përkohshëm.

1 pikë

- Kongresi zgjodhi Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar (KANC), si organin më të lartë ligjvënës duke e cilësuar atë si përfaqësues i sovranitetit të popullit e të shtetit të ri shqiptar.

1 pikë

- Këshilli nga ana tij, formoi Komitetin Antifashist Nacionalçlirimtar me atributet e qeverisë së përkohshme.

1 pikë

- U ndalua kthimi në Shqipëri i ish-mbretit Zog. Shfuqizimi i kushtetutës së monarkisë së vitit 1928.

1 pikë

- U vendos që të mos njihej asnjë qeveri tjetër që mund të krijohej brenda apo jashtë vendit.

1 pikë

Ngjarja përmbyllëse e procesit të organizimit të pushtetit prej PKSHE përfaqësohet nga mbledhja II e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar në Berat. Miratoi shndërrimin e Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar në Qeveri Demokratike që do të vazhdonte luftën deri në çlirimin e plotë të vendit dhe do të ushtronte pushtetin deri në organizimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike për Asambleenë Kushtetuese.

1 pikë

5.

a)

Të përbashkëtat:

- Forma monarkike e qeverisjes

- Garantimi i lirive të individit në planin shoqëror, ekonomik

- Shteti laik (i ndarë nga feja)

- Ndarja e pushteteve

- Gjuha zyrtare shqipe

Nxënësi fiton:

4 pikë nëse shkruan katër nga të mësipërmet

- 3 pikë** nëse shkruan tre nga të mësipërmet
- 2 pikë** nëse shkruan dy nga të mësipërmet
- 1 pikë** nëse shkruan një nga të mësipërmet
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

Të veçantat:

- Forma e qeverisjes kaloi nga Monarki reale, substanciale (Statuti Organik dhe Statutit Themeltar i Mbretërisë Shqiptare), në monarki formale me kompetenca të kufizuara (Statuti i Zgjeruar i Lushnjës).
- Në Statutin Organik, Fuqitë e Mëdha kishin rol garantues për sa i përket tërësisë territoriale dhe asnjësisë së shtetit shqiptar. Kjo gjë mungon në Statutin Themeltar të Mbretërisë Shqiptare dhe në Statutin e Zgjeruar të Lushnjës.
- Roli i pushtetit legjislativ në Statutin Organik dhe në Statutin Themeltar të Mbretërisë Shqiptare ishte shumë i kufizuar në kompetenca, kontrollohej nga monark u dhe nuk kishte kontroll mbi pushtetin ekzekutiv. Në statutin e Lushnjës, pushteti legjislativ, kishte kompetenca të gjera, ishte plotësisht rezultat i zgjedhjeve.
- Në Statutin Organik ruheshin kapitulationet e dhëna nga Perandoria Osmane, në statutin e Zgjeruar të Lushnjës dhe në Statutin Themeltar të Mbretërisë këto nuk ishin prezentë.

Nxënësi fiton:

- 4 pikë** nëse shkruan katër nga të mësipërmet
- 3 pikë** nëse shkruan tre nga të mësipërmet
- 2 pikë** nëse shkruan dy nga të mësipërmet
- 1 pikë** nëse shkruan një nga të mësipërmet
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

6.

a)

- Traktati i Shën Stefanit u nënshkrua më 3 mars 1878 mes Rusisë dhe Perandorisë Osmane. **1 pikë**
- Krijimi i Bullgarisë së madhe do të përfshinte territoret lindore (Korçë, Pogradec, Strugë, Dibër, Kuçovë, Gostivar, Tetovë, Shkup, Kaçanik dhe Kumanovë. **1 pikë**
- Serbia viset veriore të Kosovës deri në Mitrovicë. **1 pikë**
- Mali i Zi mori Ulqinin, Krajën, Anamalin, Hotin, Grudën, Kelmendin, Plavën, Gucinë dhe Rugovën. **1 pikë**

b)

- Territoret që Traktati i Shën Stefanit ia jepte Bullgarisë me Traktatin e Berlinit mbeteshin nën Perandorinë Osmane. **1 pikë**
- Serbia nuk zgjerohej në drejtim të Mitrovicës dhe Prishtinës, por i jepeshin Treni, Vranja, Piroti dhe Nishi. **1 pikë**
- Mali i Zi merret krahinat e përcaktuara në Shën Stefan. **1 pikë**
- Greqisë i jepej Thesalia dhe Çamëria. **1 pikë**